

Fatlum NIKA

**DEMONSTRATAT E VITIT 1981: TË DËNUARIT E
DEMONSTRATAVE TË VITIT 1981 NGA KOMUNA E DRENASIT**

Abstrakt:

Si në gjithë Kosovën edhe në Komunën e Drenasit (Glllogocit) organizohen protesta dhe pas këtyre protestave fillojnë arrestimet dhe dënimet, qoftë individuale, qoftë grupore. Arrestimet përfshijnë pa përjashtim, mësues, studentë, mjekë, elektrikistë, kimistë dhe tregtarë. Duke u bazuar në dokumente arkivore dhe literaturë relevante, shohim se gjithë të dënuarit janë me dënime që variojnë nga disa muaj deri në disa vite. Nga materialet e përpunuara, në shumicën e aktvendimeve dhe të aktgjykimeve thuhet: "Me këtë ka kryer veprën penale të cenimit kundërrevolucionar të rregullimit shoqëror nga neni 114 të LP të RSFJ". Kjo akuzë rëndon pothuajse mbi të gjithë të dënuarit. E përbashkëta e tyre, bazuar në dokumentet (aktgjykime, aktvendime), është se të gjithë janë dënuar në "emër të popullit". Po ashtu demonstruesit e komunës së Drenasit dënohen kryesisht nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë. Duke përdorur metodologji të qartë shkencore, kryesisht të analizës së krahasimit kam arritur në përfundime të caktuara, të cilat japin një pasqyrë të përgjithshme mbi të akuzuarit dhe të dënuarit nga komuna e Drenasit (Glllogocit). Ky punim do të mbështetet në dokumente arkivore, në literaturë, mbi Demonstratat e vitit 1981, në Arkivin Komunal në Shoqatën e ish të Burgosurve Politikë të Kosovës - Dega në Drenas e të gazetës "Rilindja". Në fund të këtij punimi do mundohem të arrij një pasqyrim të përgjithshëm mbi ngjarjet e asaj kohe duke u bazuar në dokumente arkivore.

Fjalë kyçe: *Demonstrata e vitit 1981, Komuna e Drenasit, Aktakuza politike, Denimet.*

Demonstratat e vitit 1981 mars-prill në Kosovë

Pas vdekjes së Titos në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë, do të kemi politikë në dy kahe: që serbët ta marrin në dorë drejtimin e RSFJ-së dhe në anën tjetër kemi ruajtjen e trashëgimisë së Titos e krijuar pas Luftës së Dytë Botërore. Drejtimin e shtetit socialist federative e mori Eduard Kardeli dhe filloi të punojë sipas planit të tij. Vdekja e Titos thelloi edhe më tej ndarje në kuadër të RSFJ-së dhe kështu në një situatë të brishtë politike në Kosovë do të shpërthenin demonstratat, të cilat do ta shfaqnin pakënaqësinë mes kombeve e popujve brendapërbrenda Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Këto demonstrata shpërthyen si pasojë e kushteve të rënda ekonomike, joqëndrueshmëria politike dhe si të tilla morën karakter social e kombëtar.¹

Ajo që filloi si demonstrata studentore në Universitetin e Prishtinës për të protestuar kundër kushteve të mjerueshme të jetesës dhe kushtet në të cilat studiohej, u shndërrua shpejt në një lëvizje politike për statusin e republikës dhe barazinë absolute me pjesët e tjera të Federatës Jugosllave. Kosovës gjithmonë i ishte mohuar statusi i republikës, sepse kjo do t'i jepte të drejtën ligjore për t'u shkëputur nga Federata, gjë që serbët e kundërshtonin me fanatizëm. Beogradi i quajti trazirat "*kundërrevolucionare*" dhe vendosi një gjendje rrethimi. Demonstratat të cilat u përhapën në mbarë Kosovën si një kryengritje kundër sundimit serb, u shuan shpejt dhe brutalisht kur policia dhe ushtria federale u sollën nga Serbia dhe vendet tjera të Jugosllavisë. Mijëra shqiptarë të arrestuar në demonstrata kryesisht paqësore, u dënuan me vite të gjata burg për veprimtari kundërrevolucionare dhe separatiste. Viti 1981 shënoi fillimin e pushtimit gradual serb të Kosovës.² Pas thyerjes së pjatave në Mensën e Studentëve, organizatorët dolën shpejt në rrugë dhe filluan të brohoritin: "*Kushte*", "*Disa në karrige të buta e disa pa bukë*",

¹ Shkodran Imeraj, *Kosova 1968-1990*, Instituti i Historisë "Ali Hadri", Prishtinë 2021, 129-130.

² Robert Elsie, *Historical Dictionary of Kosovo*, The Scarecrow Press, United Kingdom 2011, 110-111.

“Poshtë borgjezia e kuqe”, “Lirioni shokët tanë”. Këtu nuk kishte parulla, por vetëm rrëmujë dhe papritmas u shfaq edhe policia. Ata intervenuan brutalisht afër Fakulteti Filozofik. Studentët u sulmuan madje bënë përpjekje për ta shpëtuar një, i cili ishte rrahur keq nga policia.

Këto masa qëndruan deri në 05:00 ose 06:00 të mëngjesit, gjersa policia raportonte 2 000 studentë protestues.³ Ndërsa historiani Noel Malcolm thotë se në demonstratë në fillim ishte numri 500 veta, por më vonë shkoi duke u rritur 3 000 deri në 4 000, sepse gjatë kësaj periudhe po luhej një ndeshje futbollit.⁴ Ndërsa bilanci i pasojave ishte 19 policë të lënduar, shtatë makina, dy autobusë dhe një kafe bar privat u shkatërrua.⁵ Më 26 mars 1981 vjen stafeta e Titos dhe komunistët e Kosovës, bënë thirrje për dalje masive në pritje të stafetës së Titos dhe më këtë të tregonin se sa ishin të përkushtuar në vazhdimin e rrugës së Titos dhe Jugosllavisë së Brozit.⁶ Atë ditë më 26 mars 1981 “Stafeta mladosti” mbledhi 40 000 shikues. Njësitë policore kishin sjellë policë e helikopterë, kishin bllokuar konviktet e kishin maltretuar njerëz.

Parullat ishin të ndryshme: “Trepça punon, Beogradi ndërton”, “Republikë, Kushtetutë, ja me hatër ja me dhunë”, “Bashkim të trojeve shqiptare”, “Rroftë marksizëm-leninizmi”, “Poshtë revizionizmi”, “EHo, EHo”, “Duam vetëvendosje”, “Poshtë robëria, rroftë liria”, “Duam punë”, “Lirioni të burgosurit”, “Jemi shqiptarë, s’jemi jugosllavë”.⁷ Ndërsa deri në vitin tjetër ishin rreth 2 mijë “nacionalistë” të dënuar.⁸ Sa i përket se nga kush u nxitën demonstratat, Oliver Schmit përmend se diaspora kishte ndikim, përmes së cilës në Kosovë depërtonte nacionalizmi.⁹ Demonstratat patën jehonë kudo në mediat e gazetat e huaja, por edhe vendore. Gazeta “Frankfurter Allgemeine Zeitung”, 9 prill 1981, gazeta amerikane “The New York Times” e 27 prillit 1981, raportuan për këto demonstrata.¹⁰ Bartësit e

³ Atdhe Hetemi, *Lëvizjet...*, 222.

⁴ Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, Koha, Prishtinë 2019, 387.

⁵ Atdhe Hetemi, *Lëvizjet...*, 222.

⁶ Po aty, 228

⁷ Po aty, 230-232

⁸ Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar*, Koha, Prishtinë 2009, 75.

⁹ Oliver Schmit, *Kosova - histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*, Koha, Prishtinë 2012, 222.

¹⁰ Jakup Krasniqi, *Lëvizja për Republikën e Kosovës 1981-1991*, Buzuku, Prishtinë 2011, 80-

drejtpërdrejtë të ngjarjeve të 1981, politika zyrtare i cilësoi si armiq dhe kundërrevolucionarë. Madje i kishte quajtur edhe *pleh*. Më vonë u kishte ngjitur nofka të tjera, si: *irredentistë, separatistë, barbarë, terroristë* madje edhe *kanibal*.¹¹

Të dënuarit e Demonstratave të vitit 1981 në komunën e Drenasit (Glllogocit)

Si në gjithë territorin e Kosovës, edhe komuna e Drenasit (Glllogocit) ishte pjesë e lëvizjeve demonstrative gjatë muajve mars-prill 1981, por edhe gjatë muajve tjerë të vitit 1981. Më 1 prill 1981 në demonstratën e asaj dite arrestohet Enver Topilla, të cilin më datën 18 janar 1982, Gjykata e Qarkut në Prishtinë e “shpallë fajtor për veprën penale të cenimit kundërrevolucionar të rregullimit shoqëror nga neni 114 të LP RSFJ dhe e ka gjykuar me dy vjet burgim, ku i llogaritet paraburgimi prej 29 korrikut 1981 dhe t’i paguaj shpenzimet e procedurës penale si dhe paushallin prej 600 dinarësh”*.¹²

Demonstratat vazhduan edhe më 2 prill 1981. Gazeta “Rilindja” shkruante se: “*Demonstruesit e Glllogocit u dënuan nga njëmbëdhjetë vjet deri në shtatë vjet burg*”. Demonstruesit akuzoheshin për: “*sulm të drejtpërdrejtë kundër rendit kushtetues, për bashkim më qëllim të veprimtarisë armiqësore dhe sjellje vandaliste të akuzuarit u dënuan prej 11 vjet deri në 7 vjet. Gjatë demonstratave kundërrevolucionare të 2 prillit të njëmbëdhjetë të dënuarit manifestuan sjellje shkatërrimtare duke thyer vitrinat dhe dritaret e ndërtesave, duke përmbysur dhe shkatërruar automobilat dhe duke sulmuar milicinë me gurë dhe me mjete të tjera*”. Me 11 vjet dënohen grupi i përbërë prej: Skënder Ahmetit, Nezir Krasniqi dhe Enver Dugolli. Me 9 vjet dënohen: Haki Istogu, Sejdi Leku, Fatime Seniku. Me shtatë vjet burg dënohen: Ramadan Nika, Naim Fetahu, Abdyl Elshani,

81.

¹¹ Ukshin Hoti, *Filozofia politike e çështjes shqiptare*, Zenit Editions, Tiranë 2019, 150.

* 600 dinarë, shprehur në euro i bie gjashtëdhjetë e tre euro (63€), 1981-1985 inflacioni ishte në rritje.

¹² Shoqata e ish të Burgosurve Politikë - Dega Drenas (më tej: SHBPK), Fondi SHBPK - Drenas, Kërkesa, Kutia 4, Fletëregjistrim, 6 shtator 2002. Dokumenti Nr. 190/4.

Ajet Mala, Selim Bucolli.¹³ Ky grup i përbërë prej 11 veta dënohen nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë për veprën penale cenimi kundërrevolucionar i rregullimit shoqëror nga neni 114 i LPJ-së, të akuzuar me aktakuzën e prokurorisë publike të qarkut në qytetin e Prishtinës. Për të akuzuarit e lartëpërmendur në arsyetimin e aktgjykimit thuhet: Skënder Ahmetin, ka marrë pjesë në protestat e 2 prillit 1981 prej orës 10:00 e deri 17:00, gjatë lëvizjes së grupit nëpër rrugët publike të Gllogocit, prej qendrës arsimore “Marshali Tito”, e deri te OBPB “Feronikeli”*, ka brohoritur parullat: “Kosova Republikë”, “Republikë kushtetutë, ja me hatër ja me luftë”, “Duam Republikë”, “Duam shkollën Skendërbeun, e jo Mareshalin Tito”, Nezir Krasniqin, “ka marrë pjesë aktive të shkatërrimit të pasurisë shoqërore në përmasa të mëdha”, Haki Istogu, ka marrë pjesë në Demonstratën e 2 prillit 1981, ka brohoritur parullat si në rastet tjera, ka nxjerr nga autobusi i Bjello Pojes, me dhunë shoferin, prej nxënësve heq emblemën me emrin QAMO “Marshal Tito”, si dhe në OBPB “Feronikeli”, ka rrotulluar një “Folsfagen”.¹⁴

Selim Bucollin, ka marrë pjesë në demonstratë nga ora 12:00, i ka ftuar qytetarët t’ju bëjnë rezistencë organeve të Punëve të Brendshme, duke thënë: “Shokë përpara t’i mbrojmë fëmijët tanë nga milicia e Nishit, erdhën e kanë me na i mbytur fëmijët”. Më tej thuhet se në shitoren e tij private u ka dhënë demonstruesve bishta të sëpatave e të lopatave dhe janë nisë tek Feronikeli. Enver Dugollin, ka marrë pjesë në demonstrata, në fillim në oborrin e shkollës QAMO “Marshal Tito”, gjatë pushimit pas orës së dytë, së pari ka hyp në veturën e profesorit Fatmir Krasniqit duke i ftuar nxënësit që t’ju kundërvihen masave të sigurimit për t’u larguar duke brohoritur: “Vllazër dhe motra mos e koritni Drenicën heroike”, “Poshtë fashizmi jugosllavë”, “Rroftë Bajram Gashi”, “Rroftë Ismajl Grajçevci”, “Rroftë Adem Demaçi”, “Duam Republikë”, “Poshtë udhëtarë tradhtarë për popullin shqiptar”, e pastaj bashkë më të tjerët dhe Elmie Plakiqin kanë nxjerrë flamurin kombëtar shqiptar. Ramadan Nika, ka marrë pjesë në demonstratë prej orës 10:00 deri

¹³ SHBPK, F. SHBPK - Drenas, Kërkesa, Kutia 4, Fletëregjistrim, 9 prill 2002. Dokumenti Nr. 160/4.

¹⁴ SHBPK, F. SHBPK - Drenas, Kërkesa, Kutia 5, Fletëregjistrim, 24 tetor 2002. Dokumenti Nr. 212/5.

* Feronikeli, është një kompleks industrial që ndodhet në Komunën e Drenasit, të mineraleve hekur dhe nikel.

17:00, duke filluar nga QAMO “*Marshal Tito*”, “Çikatrovë e Re”, e deri të OBPB “*Feronikeli*”.¹⁵

Në demonstrata kanë marrë pjesë edhe Naim Fetahu, Avdyl Elshanin, Ajet Mala dhe Selim Bucolli, kanë organizuar dhe kanë ftuar demonstrues që t’ju bëjnë rezistencë thirrjes së punëtorëve të milicisë, kanë gjuajtur dhe thyer xhamat e automobilave. Në mesin e të dënuarve ishte edhe Fatime Seniku ku mori pjesë në demonstrata gjatë lëvizjes nëpër rrugët publike të Glllogocit, prej “Tregut të blertë, te OPB “*Feronikeli*” dhe anasjelltas gjerë të QAMO “*Marshal Tito*” dhe ndërtesa komunale ka brohoritur parulla armiqësore.¹⁶

Në emër të popullit u dënuan, nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë, pas mbajtjes së seancës më datën 26 nëntor 1981, të akuzuarit Pajazit Krasniqi, Sherif Krasniqi, Rrahim Bardiqi, Fatmir Mehmeti, Nexhmi Kelmendi, Xhavit Mustafa. Për Pajazit Krasniqin dhe Sherif Krasniqin së bashku me të dënuarin tjetër Jakup Krasniqin, kishin formuar grupin për kryerjen e veprës penale të drejtura në rrëzimin e pushtetit, thyerjen e vëllazërimit e të bashkimit, prishjen e barazisë së kombeve dhe kombësive dhe ndryshimin antikushtetues të rregullimit federativ të shtetit, ashtu që vepruan në kuadër të Partisë Marksiste-Leniniste të shqiptarëve në Jugosllavi, biseduan tematika politike shoqërore, bënë plane për mënyrën e punës së grupit, siguruan dhe shpërndanë literaturë me përmbajtje tejet armiqësore, siç janë: “*Shota dhe Azem Galica*”, “*Nënë Shqipëria*”, “*Gjarpërinjtë e gjakut*”, “*Konferenca e partive në Moskë më 1960*”, revistat “*Liria*”, “*Lajmëtari i Lirisë*”, këtë literaturë ua shpërndanë personave tjerë me qëllim që t’i anëtarësojnë për veprimtari armiqësore, si dhe u folën të tjerëve për sistemin “*e drejtë*” të RP të Shqipërisë, me ç’rast sistemin e RSFJ-së e paraqitën të “*të padrejtë*” dhe mbi këtë u mbajt ligjërata me karakter armiqësor Shyqeri Krasniqit, Asllan Krasniqit, Sokol Krasniqit, Mujë Krasniqit.

Në aktgjykimin e kësaj date pos së tjerave përmendet edhe tentimi i tyre për ndërrimin e emrit të shkollës së mesme në Glllogoc nga “*Josip Broz Tito*”, në “*Skënderbeu*”. Mbi këtë grup rëndon edhe akuza “*e pas demonstratave armiqësore të muajit mars dhe prill 1981 për shkrimin e*

¹⁵ SHBPK, F. SHBPK - Drenas, Kërkesa, Kutia 5, Fletëregjistrim, 24 tetor 2002. Dokumenti Nr. 212/14.

¹⁶ SHBPK, F. SHBPK - Drenas, Kërkesa, Kutia 6, Fletëregjistrim, 12 tetor 2005. Dokumenti Nr. 279/6.

parullave dhe letrave anonime, me ç' rast në një tubim lexuan edhe materialin armiqësor "lufta e jonë" është e drejtë dhe do të triumfojë, e në ndërkohë i akuzuari Sherif Krasniqi, u bë anëtar i një grupi tjetër nën udhëheqjen e Rrahim Bardiqit, për veprimtari armiqësore në shkrimin e parullave dhe letrave armiqësore".¹⁷

Për të akuzuarin Rrahim Bardiqi, Fatmir Mehmeti, Nexhmi Kelmendi dhe Xhavit Mustafa, thuhet në aktgjykim, sepse kishin marrë pjesë në Demonstratat e mars-prillit 1981 në Prishtinë, ku edhe e formuan grupin e tyre *"për rrëzimin e pushtetit të klasës punëtore dhe punonjësve, thyerjen e vëllazërim e të bashkimit, prishjen e barazisë së kombeve dhe kombësive dhe ndryshimin antikushtetues të rregullimit federativ të shtetit"*. Këta ngarkohen edhe me akuzën për themelimin e grupit *"Marksist e Leninist për çlirimin e Kosovës"*, caktuan parullat e komunikimit me numra, që për qëllim kishin shkrimin e tyre, masivizimin e grupit dhe pastaj ky grup kishte mbajtur mbledhjen e dytë më 12 shtator 1981 dhe mbledhja e tretë më 22 shtator 1981 u vendos që më 24 shtator 1981 të shkruhen parullat. Këto parulla u shkruan në fshatin Matiqan, te varrezat në *"Tauk Bashqë"*, parullat *"Kosova Republikë"*, *"Poshtë Borgjezia"*, *"Shokët nga burgu"*. Për Rrahim Bardiqin thuhet se ishte pjesë në Demonstratën e 1 dhe 2 prillit 1981 në Prishtinë, në ditën e parë i pajisur me gurë dhe shkop, në ditën e dytë me thikë, duke iu kundërvënë organeve të SPB-së e para KK të LK me megafon dhe në një bli, brohoriti parulla armiqësore *"Kosova Republikë"*, *"Shokët nga burgu"*, *"Poshtë borgjezia"*, *"Republikë, Kushtetutë, ja me hatër ja me luftë"*.

Për Fatmir Mehmetin, Nexhmi Kelmendin dhe Xhavit Mustafën rëndon kjo akuzë. Ky grup dënohet për *"veprimtari armiqësore nga neni 136 al. 1 lidhur me nenin 114 të LPJ"*. Po ashtu të gjithë këta obligohen të paguajnë shpenzimet e procedurës penale, me shumën prej 500.00 dinarë*.¹⁸ Në emër të popullit u dënua edhe grupi i përbërë nga Ismet Sopi, Bajram Gashi, Alush Thaçi, Qerkin Sopi, Nuhi Sopi, Halil Kuliqi, Naim Bujupi, nga

¹⁷ SHBPK, F. SHBPK - Drenas, Kërkesa, Kutia 2, Fletëregjistrim, 8 janar 2002. Dokumenti Nr. 84/2.

¹⁸ SHBPK, F. SHBPK - Drenas, Kërkesa, Kutia 1, Fletëregjistrim, 7 dhjetor 2001. Dokumenti Nr. 11/1.

* 500 dinarë, shprehur në euro i bie pesëdhjetë e dy euro (52€), 1981-1985 inflacioni ishte në rritje.

Gjykata e Qarkut në Prishtinë, ku Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë, në arsyetimin e aktgjykimit të datës 29 korrik 1981. Bajram Gashi, Ismet Sopi, Alush Thaçi akuzohen për “veprimtari armiqësore nga neni 136. al. 1. lidhur me nenin 1116. al. 1. LPJ”, ndërsa Halil Kuliqi, Naim Bujupi, për veprën penale “cenim kundërrevolucionar i rregullimit shoqëror nga neni 114. LPJ”.

Qerkin e Nuhi Sopi, për veprën penale “bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136. al. 2., lidhur me nenin 116. al. 1. LPJ”.¹⁹ Për Bajram Gashin në arsyetim thuhet se ka vu kontakte me Ismail Haradinajn si kryetar i “Komitetit të vendit” në Deçan*, gjatë muajit shtator 1980 së bashku me Alush Thaçin dhe Ismet Sopin dhe e kanë formuar grupin ilegal armiqësor për kryerjen e veprës penale të drejtuar që me forcë e në mënyrë antikushtetuese, nga territori i RSFJ-së të shkëputet KSA e Kosovës dhe viset e tjera të banuara me shqiptarë dhe t’i bashkëngjitën RPS-së së Shqipërisë. Ky grup u pagëzua me emrin “Komiteti i vendit”, i cili duhej të vepronte sipas platformës ideologjike të organizatës ilegale “Fronti i Kuq Popullor”.

Në këtë organizatë Bajram Gashi kishte pozitën e sekretarit si dhe pseudonimi i tij ishte “Skyfteri”. Në arsyetim shtohet më tej se Bajram Gashi mori përsipër furnizimin me literaturë armiqësore. Pos kësaj përmendet edhe aktiviteti i tij në Demonstratën e 2 prillit 1981, në Glllogoc. Në arsyetimin e aktgjykimit thuhet se Bajram Gashi i pranon akuzat e tij dhe kur pyetet se çka e frymëzoi atë të marrë pjesë në demonstratë ishte koha kur po e lexonte “Manifestin komunist” të Karl Marksit, ku thuhet se “çdo kufi i caktuar me luftë, shkakton luftën e re”, ndër të tjera thuhet se frymëzim ishte edhe Lidhja e Prizrenit. I akuzuar tjetër ishte edhe Ismet Sopi ku akuzat ndaj tij nuk dallojnë nga akuzat e Bajram Gashit vetëm se i shtohen edhe parullat e thirrura prej tij si dhe duke qëndruar në ballë të turmës së nxënësve dhe duke brohoritur parullat: “Duam Republikë”, “Lart grushti i proletariatit”, “Rroftë revolucioni popullor”, “Lironi shokët”, “Republikë kushtetutë ja me hatër ja me luftë”, ndërsa më datën 3 prill 1981 së bashku me Naim Bujupin me nxënësit e shkollës Arllat-Llapushnik, ka brohoritur parullat armiqësore, po ashtu më 3 prill 1981 në shkollën fillore “Emin Duraku”, me iniciativën e tij u shkruan parullat “kërkojmë republikë”, “kërkojmë lirinë e studentëve” dhe

¹⁹ SHBPK, F. SHBPK - Drenas, Kërkesa, Kutia 8, Fletëregjistrim. Dokumenti Nr. 360/8.

në këtë tubim u bënë përgatitje për dalje të tjera në demonstrata.²⁰ Për Alush Thaçin në arsyetim thuhet se së bashku me Bajram Gashin dhe Ismet Sopin kanë formuar grupin ilegal armiqësor për kryerjen e veprës penale të drejtuar që me forcë e në mënyrë antikushtetuese, nga territori i RSFJ-së, të shkëputet KSA e Kosovës dhe viset tjera të banuara me shqiptarë të bashkohen RPS të Shqipërisë, kurse grupin e pagëzuan me emrin “*Komiteti i vendit*”, ku ky komitet duhej të vepronte sipas platformës ideologjike të organizatës ilegale jashtë vendit “*Froni kuq popullor*”, emëruan udhëheqësinë, caktuan detyra konkrete, si dhe është zgjedhur kryetar i saj me pseudonimin “Bregu” dhe vazhdoi të shkëmbejë literaturë dhe të lexojë materiale me përmbajtje armiqësore.

Alush Thaçi në bazë të aktgjykimit kishte kryer veprën penale, “*bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136. al. 1. LPJ, lidhur me veprën penale cenimi i tërësisë territoriale nga neni 116. al. 1. LPJ*”.²¹ I akuzuari i katërt nga ky grup ishte edhe Halil Kuliqi. Mbi të rëndonte akuza se nga viti 1978 kishte filluar të lexojë e të gjejë persona “*ithtarë*” (siç thuhet në aktgjykim) për shkëmbimin e materialeve dhe literaturës me përmbajtje armiqësore, pastaj më 2 prill 1981 ka kryer veprën “*të drejtuar në rrëzimin e pushtetit të klasës punëtore e të punonjësve, minimin e rregullimit shoqëror-politik të përcaktuar me kushtetutë, thyerjen e vllazërim-bashkimit e prishjen e barazisë së kombeve e të kombësive dhe ndryshimin antikushtetues të rregullimit federative të shtetit*”.

Pas akuzës për veprën pastaj jepet puna e tij në demonstratë, ku thuhet se Halil Kuliqi kishte marrë fletë të formatit A4 dhe ka shkruar apelin me titull “*Vëllezër e motra, mos e koritni Drenicën e kuqe - dilni në ora 10:00*”, po ashtu edhe parullat: “*Duam republikë*”, “*Rroftë Republika e Kosovës*”, “*Rroftë rinia shqiptare*”, “*Poshtë borgjezia jugosllave*”, ku ua ka shpërndarë disa nxënësve të shkollës fillore “Vllaznim-Bashkimi” në Gllogovc, dhe prej orës 12:00 e deri në ora 14:00 ka marrë pjesë në demonstrata. Halil Kuliqi në

²⁰ SHBPK, F. SHBPK - Drenas, Kërkesa, Kutia 5, Fletëregjistrim, 30 shtator 2002. Dokumenti Nr. 208/5.

* Deçani është qytezë në pjesën perëndimore të Kosovës. Kufizohet me komunën e Pejës, Gjakovës dhe me Republikën e Shqipërisë. Deçani është i njohur për Kishën Ortodokse. Territori i kësaj komune është 180km² dhe ka 42 fshatra.

²¹ SHBPK, F. SHBPK - Drenas, Kërkesa, Kutia 10, Fletëregjistrim, 10 nëntor 2010. Dokumenti Nr. 461/10.

bazë të aktgjykimit kishte kryer veprën penale “*cenim kundërrevolucionar i rregullimit shoqëror, nga neni 114. LPJ*”. Për të akuzuarin e pestë, Naim Bujupin, thuhet se kishte marrë pjesë në demonstrata duke thirrur parulla “*Duam republikë*”, “*Republikë, Kushtetutë, ja me hatër ja me luftë*”, pra sipas aktgjykimit ka kryer veprën penale “*cenim kundërrevolucionar i rregullimit shoqëror, nga neni 114. LPJ*”. Të akuzuar në këtë grup ishin edhe Qerkin Sopi dhe Nuhi Sopi. Qerkin Sopi dënohet për veprën penale “*bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136. al. 1. LPJ, lidhur me veprën penale cenimi i tërësisë territoriale nga neni 116. al. 1. LPJ*”. Edhe Nuhi Sopi dënohet për këtë veprën penale. Po ashtu edhe në bazë të nenit 33, 34, 136, al. 1. e al. 2., 116. al. 1. E 114. LPJ dhe nenit 351. LPP.²² Përpos dënimeve me burgim, këta obligohen që secili veç e veç ta paguaj paushallin gjyqësor nga 500.00 dinarë*, ndërsa Bajram Gashi, Ismet Sopi, Alush Thaçi, Qerkin Sopi dhe Nuhi Sopi detyrohen t’i paguajnë edhe shpenzimet për mbrojtën e caktuar sipas detyrës zyrtare.²³

Të dënuar në emër të popullit janë edhe grupi i përbërë prej: Mehmet Bislimit (fshati Prekaz i Epërm, Skënderaj), Muhamet Gashit (Vërbovc, Drenas), Ismet Kabashi (fshati Polac, Skënderaj), nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë më datën 18 nëntor 1981. Gjykata i shpall fajtor, sepse këta kishin qëllim “*rrëzimin e pushtetit të klasës punëtore e të punonjësve, të minimimit të rregullimit shoqëror politik të sistemit vetëqeverisës, thyerjen e vllazërim-bashkimit, prishjen e barazisë së kombeve e të kombësive dhe ndryshimin antikushtetues të rregullimit federative të shtetit*”. Për Mehmet Bislimin thuhet se kishte marrë pjesë në Demonstrata më 11 mars, 1 dhe 2 prill 1981, kurse Muhamet Gashi dhe Ismet Kabashi kishin marrë pjesë 1 dhe 2 prill 1981. Në aktgjykim thuhet se kanë marrë pjesë në demonstratë armiqësore kundërrevolucionare, ku së bashku kishin brohoritur parulla me karakter armiqësor “*Republikë, Kushtetutë, ja me hatër ja me luftë*”, “*Lironi shokët nga burgu*”, “*Trepça punon, Serbia e shfrytëzon*”. Për të akuzuarin Muhamet Gashin në aktgjykim thuhet se kishte shkruar rreth 70 parulla armiqësore me

²² SHBPK, F. SHBPK - Drenas, Kërkesa, Kutia 5, Fletëregjistrim, 30 shtator 2002. Dokumenti Nr. 205/5.

²³ SHBPK, F. SHBPK - Drenas, Kërkesa, Kutia 8, Fletëregjistrim. Dokumenti Nr. 360/8.

* 500, 00 dinarë, shprehur në euro i bie pesëdhjetë e dy euro (52€), 1981-1985 inflacioni ishte në rritje.

ngjyrë të kuqe dhe të kaltër, të tilla si: “*Kosova Republikë*”, “*Poshtë shovinizmi serb dhe çdo shovinizëm tjetër*”, prej të cilave 40 copë ka shpërndarë së bashku me Mehmet Bislimin, para shtëpive në rrugën “*Vëllazërim - Bashkimi*”, në afërsi të tregut të gjelbër, në natën e 3 dhe 4 korrikut 1981. Bazuar në këto, ky grup dënohet për veprën penale cenimi kundërrevolucionar i rregullimit shoqëror nga neni 114 i LPJ. Mehmet Bislimi, Muhamet Gashi si dhe Ismet Kabashi obligohen t’i paguajnë shpenzimet e procedurës penale në emër të paushallit në shumën prej 500.00 dinarë.²⁴

I dënuar për pjesëmarrje në Demonstratat e 2 prillit 1981 është edhe Agim Kacurreti, ku dënohet nga Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Glllogoc nga neni 18 al. 1 pika 1 dhe 4 e ligjit mbi rendin dhe qetësinë publike, e në vështrim të neneve 73, 195, 199 dhe 267 të ligjit mbi kundërvajtje, më datën 18 mars 1982 mori aktvendim, se Agim Kacurreti më datën 2 prill 1981 kishte marrë pjesë në demonstratë duke brohoritur parulla armiqësore: “*Kosova republikë*”, “*Lironi shokët nga burgu*”, si dhe ka bojkotuar mësimin për bashkëngjitje në demonstratë dhe dënohet me kohëzgjatje prej 45 (katërdhjetë e pesë) ditësh. Ndërsa shpenzime të procedurës penale nuk kishte.²⁵ Nga Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Glllogoc, merret aktvendim për Daut Hoxhën, për veprën kundërvajtje nga neni 18 al. 1 pika 5 dhe neni 200 al. 1 pika 3 e ligjit mbi rendin dhe qetësinë publike dhe në vështrim të neneve 73, 195, 199 dhe 267 të ligjit mbi kundërvajtje, ku Daut Hoxha akuzohet sepse më datën 2 prill 1981 rreth orës 10:00 e deri në ora 13:00, iu kishte bashkëngjitur grupit të demonstruesve nëpër rrugët e Glllogocit, si dhe sjellja e tij arrogante ndaj qytetarëve dhe personave të autorizuar zyrtarë si dhe aktivistëve, ka prishur rendin dhe qetësinë publike. Daut Hoxha dënohet gjithsej me 60 (gjashtëdhjetë) ditë, nga neni 267 al. 1 pika 2 e ligjit mbi kundërvajtje. Shpenzime të procedurës penale nuk kishte.²⁶

²⁴ SHBPK, F. SHBPK - Drenas, Kërkesa, Kutia 14, Fletëregjistrim, 4 janar 2013. Dokumenti Nr. 664/14.

²⁵ SHBPK, F. SHBPK - Drenas, Kërkesa, Kutia 10, Fletëregjistrim, 29 nëntor 2011. Dokumenti Nr. 491/10.

²⁶ SHBPK, F. SHBPK - Drenas, Kërkesa, Kutia 10, Fletëregjistrim, 7 shkurt 2011. Dokumenti Nr. 472/10.

I dënuar për pjesëmarrje në demonstrata ishte edhe Murat Gashi në Demonstratën e 2 prillit 1981, ku akuzohet se u kishte dhënë demonstruesve letër hamer nga biblioteka për të shkruar parulla armiqësore. Mbi këto akuza, Murat Gashi dënohet nga Gjykata Themelore për kundërvajtje dhe sjellje të këqija gjatë Demonstratave të 1 dhe 2 prillit 1981, nga neni 197 al. 1 të LPB-së dhe 21. al. 1 pika 8 dhe 13 e marrëveshjes mbi përgjegjësinë disiplinore të kundërpropozuesit, me 30 (tridhjetë) ditë vuajtje dënimi.²⁷

Në emër të popullit nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë akuzohen edhe Zenel Gërguri, Idriz Mehmeti dhe Muharrem Berbatovci. Këta të tre shpallen fajtorë, sepse ishin *“nxitës për rrëzimin e pushtetit të klasës së punëtorëve dhe të punonjësve, ndryshimin antikushtetuar të rregullimit shoqëror, socialist e vetëqeverisës, thyerjen e vëllazërim e të bashkimit dhe barazisë së kombeve dhe kombësive”*. Për Zenel Gërgurin dhe Idriz Mehmetin më datën 2 shtator akuzohen se kishin shkruar tri parulla armiqësore dhe i vendosen në 3 muret e stacionit hekurudhor në Dobroshevc*, me parullat *“Jemi të vendosur për Republikën e Kosovës”, “Rroftë Republika e Kosovës”, dhe “Tradhtari është gjykuar nga populli”*, ndërsa më datën 4 maj 1981 këta tre të akuzuar në vendin e quajtur *“Guri i Plakës”*, kishin prerë telat e telefonit dhe në shtyllën e telefonit e vunë parullën me përmbajtje armiqësore, e shkruar në fletë hameri të formatit 71/50 cm, me përmbajtje *“Deri sa të naj lirioni shokët, aksionet vazhdojnë në emër të Republikës Socialiste të Kosovës”, “Poshtë tradhtarët e popullit shqiptar”*. Me këtë kishin kryer veprën penale propaganda armiqësore nga neni 133 al. 1 të LP RSFJ. Për këta të tre, gjykata u kishte obliguar edhe të paguajnë shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 1.000.00 dinarë*.²⁸

I dënuar nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë është edhe Halil Pecani, i cili u dënuar për shkak se kishte marrë pjesë në demonstrata në ora 14:00 në Dobrosellë, më 2 prill 1981, kishte brohoritur parulla armiqësore duke

²⁷ SHBPK, F. SHBPK - Drenas, Kërkesa, Kutia 14, Fletëregjistrim, 18 janar 2013.

Dokumenti Nr. 667/14.

* Dobroshevc, vendbanim në komunën e Drenasit.

* 1.000.00 dinarë, e shprehur në euro i bie njëzet e dy euro (22€), 1981-1985 inflacioni ishte në rritje.

²⁸ SHBPK, F. SHBPK - Drenas, Kërkesa, Kutia 10, Fletëregjistrim, 21 janar 2011.

Dokumenti Nr. 470/10.

ofenduar dhe keqtrajtuar sistemin shoqëroro-politik të Jugosllavisë. Dënohet nga neni 267. al. 1. pika 2 e ligjit mbi kundërvajtje, duke u dënuar me 60 ditë burgim.²⁹ Nga Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Glllogoc, më datën 9 prill 1981 mori vendim ta dënoi Xhevat Gashin, nxënës, me arsyetimin se më datën 2 prill 1981 kishte marrë pjesë në Demonstratë nga ora 12:00, duke filluar nga qendra e shkollës “M. Tito” Glllogovc, nëpër rrugët publike të Glllogovcit e deri te “Feronikeli” në Çikatovë të Vjetër, ndërsa më datën 3 prill 1981 kishte marrë pjesë në demonstratën prej ora 08:00 e deri në ora 14:00 prej Komoranit deri në Llapushnik duke prishur rendin dhe qetësinë publike në atë mënyrë që i ka sulmuar me gurë qytetarët dhe personat e autorizuar zyrtarë si dhe ka dëmtuar pasurinë shoqërore dhe personale, e në këtë mënyrë ka kryer veprën për kundërvajtje nga neni 18. al. 1. pika 5 e ligjit mbi rendin dhe qetësinë publike. Xhevat Gashi dënohet me 5 (pesë) muaj dhe i llogaritet paraburgimi 60 ditë. Ndërsa shpenzime të procedurës penal nuk kishte, por në emër të paushallit dënohet me 600.00 dinarë*.³⁰

Sa i përket numrit të demonstruesve që ishin pjesë e këtyre Demonstratave mars-prill 1981, gazeta “Rilindja” e datës 7 gusht 1981, shkruante se Lidhja Komuniste e Glllogocit si dhe forcat tjera progresive në aktivitetin e tyre të pakompromis kishin arritur të bënin identifikimin e organizatorëve të demonstratave, po ashtu siç thuhet edhe në këtë faqe të gazetës ata kanë arritur të identifikojnë edhe ata të cilët ishin të mashtruar e të cilët kanë marrë pjesë në demonstrata e që numri i pjesëmarrësve sillej nga 200 (dyqind) deri në 250 (dyqind e pesëdhjetë). Mbi këto demonstrata, filloi edhe shqyrtimi i masave të largimit të 105 anëtarëve nga radhët e Lidhjes Komuniste, po ashtu edhe suspendimit të 27 (njëzet e shtatë) punëtorëve nga lëmi i arsimit të mesëm dhe fillor, si dhe masa të tjera që kanë filluar të ndërmarrin më vonë në fazën e dytë të këtij aktiviteti. Më tej thuhet se pas demonstratave e pas identifikimit të organizatorëve dhe arrestimit të tyre si dhe shkruesit të parullave, në Komunën e Glllogocit ishte vendosur një qetësi relative me përjashtim të riaktivizimit të veprimtarisë armiqësore më datën 20

²⁹ SHBPK, F. SHBPK - Drenas, Kërkesa, Kutia 4, Fletëregjistrim, 8 maj 2002. Dokumenti Nr. 166/4.

* 600 dinarë, shprehur në euro i bie gjashtëdhjetë e tre euro (63 €).

³⁰ SHBPK, F. SHBPK - Drenas, Kërkesa, Kutia 10, Fletëregjistrim, 18 shkurt 2011. Dokumenti Nr. 473/10.

qershor 1981 në Bashkësinë Lokale të fshatit Obri. “Përmes institucioneve të ndryshme dhe formave të ndryshme të primitivizmit dhe format tjera të demagogjisë dhe të oportunitetit kanë arritur e kanë tentuar të na fshihen bartësit e vërtetë të veprimtarisë armiqësore”, - thuhet ndër të tjera në mbledhjen e Komitetit Krahinor të LK të Kosovës. Ajo çka theksohet më tej në këtë mbledhje është forcimi i rolit të funksionit kushtetues të bashkësisë lokale.³¹

Të dënuarit e Demonstratave të vitit 1981 nga komuna e Drenasit (ish-Glllogocit) janë:

Emrat e të dënuarve	Vitet e dënimit	Data e arrestimit/ paraburgimit
Skender Ahmeti	11 (njëmbëdhjetë) vjet	Në paraburgim prej 25 qershor 1981
Nezir Krasniqi	11 (njëmbëdhjetë) vjet	Në paraburgim prej 25 qershor 1981
Enver Dugolli	11 (njëmbëdhjetë) vjet	Në paraburgim prej 25 qershor 1981
Haki Istogu	11 (njëmbëdhjetë) vjet	Në paraburgim prej 25 qershor 1981
Sejdi Leku	11 (njëmbëdhjetë) vjet	Në paraburgim prej 25 qershor 1981
Fatime Seniku	11 (njëmbëdhjetë) vjet	Në paraburgim prej 25 qershor 1981
Ramadan Nika	7 (shtatë) vjet	Në paraburgim prej 25 qershor 1981
Naim Fetahu	7 (shtatë) vjet	Në paraburgim prej 30 qershor 1981
Abdyl Elshani	7 (shtatë) vjet	Në paraburgim prej 30 qershor 1981
Ajet Mala	7 (shtatë) vjet	Në paraburgim prej 25 qershor 1981

³¹ Gazeta *Rilindja*, 7 gusht 1981, 7.

* Abri e Epërme është një vendbanim në komunën e Drenasit. Abria e Epërme ka një popullsi prej 1 100 banorë.

Selim Bucolli	7 (shtatë) vjet	Në paraburgim prej 13 korrik 1981
---------------	-----------------	-----------------------------------

Tabela nr. 1. Të dënuarit e 11 gushtit 1981 me aktgjykimin P-nr.121/81.³²

Emrat e të dënuarve	Vitet e dënimit	Data e arrestimit / paraburgimit
Pajazit Krasniqi	9 (nëntë) vjet	2 tetor 1981
Sherif Krasniqi	10 (dhjetë) vjet	26 shtator 1981
Rrahim Bardiqi	8 (tetë) vjet	26 shtator 1981
Fatmir Mehmeti	7 (shtatë) vjet	26 shtator 1981
Nexhmi Kelmendi	6 (gjashtë) vjet	26 shtator 1981
Xhavit Mustafa	6 (gjashtë) vjet	26 shtator 1981

Tabela nr. 2. Grupi i të dënuarve nga data 26 nëntor 1981.³³

Emrat e të dënuarve	Vitet e dënimit	Data e arrestimit/ paraburgimit
Bajram Gashi	15 (pesëmbëdhjetë) vjet	Mungon
Ismet Sopi	14(katërbëdhjetë) vjet	3 qershor 1981
Alush Thaçi	13 (trembëdhjetë) vjet	22 prill 1981
Halil Kuliqi	11 (njëmbëdhjetë) vjet	6 qershor 1981
Naim Bujupi	12 (dymbëdhjetë) vjet	29 qershor 1981
Qerkin Sopi	8 (tetë) vjet	5 gusht 1981
Nuhi Sopi	7 (shtatë) vjet	5 gusht 1981

Tabela nr. 3. Grupi i të dënuarve të datës 29 korrik 1981.³⁴

Emrat e të dënuarve	Vitet e dënimit	Data e arrestimit/ paraburgimit
Mehmet Bislimi	8 (tetë) vjet	13 korrik 1981
Muhamet Gashi	6 (gjashtë) vjet	16 gusht 1981
Ismet Kabashi	4 (katër) vjet	29 gusht 1981

Tabela nr. 4. Të dënuarit më 18 nëntor 1981.³⁵

³² SHBPK, F. SHBPK - Drenas, Kërkesa, Kutia 8, Fletëregjistrim, 29 nëntor 2011. Dokumenti Nr. 375/8.

³³ SHBPK, F. SHBPK - Drenas, Kërkesa, Kutia 1, Fletëregjistrim, 7 dhjetor 2001. Dokumenti Nr. 11/1.

³⁴ SHBPK, F. SHBPK - Drenas, Kërkesa, Kutia 8, Fletëregjistrim. Dokumenti Nr. 360/8.

³⁵ SHBPK, F. SHBPK- Drenas Kërkesa, Kutia 14, Fletëregjistrim, 4 janar 2013. Dokumenti

Emrat e të dënuarve	Vitet e dënimit	Data e arrestimit / paraburgimit
Zenel Gërguri	3 (tre) vjet e 6 (gjashtë) muaj	17.07.1985
Idriz Mehmeti	3 (tre) vjet e 6 (gjashtë) muaj	26.06.1985
Muharrem Berbatovci	2 (dy) vjet e 6 (gjashtë) muaj	26.06.1985

Tabela nr. 5. Të dënuarit: Zenel Gërguri, Idriz Mehmeti dhe Muharrem Berbatovci.³⁶

I dënuar për pjesëmarrje në Demonstratën e vitit 1981 ishte edhe Izet Abdyi, i cili u arrestua më 3 shtator dhe u mbajt 30 ditë, deri më 3 tetor të vitit 1981.³⁷ Përpos tij, ishin të arrestuar edhe Ganimete Demaku-Gjeli, e cila u arrestua më 2 gusht 1981 dhe u lirua më 2 tetor 1981, gjithsej 60 (gjashtëdhjetë) ditë burgim.³⁸ Për kundërvajtje u dënuan edhe: Elmije Plakiqi nga Nekoci me 18 ditë, Agim Krasniqi nga Negroci me 90 ditë, Habib Morina nga Çikatova me 60 ditë, Fatmir Hoxha nga Damaneku me 60 ditë, Ramadan Zariqi nga Baica me 60 ditë, Hidajdet Gashi nga Llapushniku me 120 ditë, të gjithë të dënuar gjatë vitit 1981.^{39*}

Për të dënuarit e demonstratave të vitit 1981 në Komunën e Drenasit, mbeshetur në dokumente nga arkivi, literaturën relevante, që vënë në pah mënyrën e ngritjes së akuzës kryesisht nga dy Gjykata, lokale e komunës (Gjykata për Kundërvajtje), si dhe nga ajo qendrore e RSFJ- së (Gjykata e

Nr. 664/14.

³⁶ SHBPK, F. SHBPK- Drenas Kërkesa, Kutia 10, Fletëregjistrim, 21 janar 2011. Dokumenti Nr. 470/10.

³⁷ SHBPK, F. SHBPK- Drenas Kërkesa, Kutia 6, Fletëregjistrim, 16 shtator 2008. Dokumenti Nr. 290/6.

³⁸ SHBPK, F. SHBPK- Drenas Kërkesa, Kutia 8, Fletëregjistrim, 1 dhjetor 2011. Dokumenti Nr. 378/8.

³⁹ Selman Krasniqi, *Drenica e Epërme dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës*, (Prishtinë: Agjensia Shtetore e Arkivave të Kosovës, 2015), 519.

* Disa nga të dënuarit sikur Jakup Krasniqi i cili vjen nga Komuna e Drenasit, në mungesë materialit si dhe dokumenteve arkivore, dosja e Jakup Krasniqit dhe disa të tjerëve nga kjo komunë kanë mbetur pa u studiuar.

Qarkut në Prishtinë), e deri tek aktakuza për demonstruesit që diheshin nga organet e RSFJ- së, mund të arrijmë në disa përfundime:

Nga këto demonstrata dhe dënime politike e pësuan të rinjtë e të rejtat e Komunës së Drenasit, mjekët, mësuesit, kimistët, tregtarët, pra nga të gjitha moshat dhe profesionet. Nga numri i demonstruesve në demonstratën e vitit 1981 nga ajo që shkruan gazeta Rilindja e datës 11 gusht 1981 thuhet se numri i të zbuluarve qoftë edhe atyre të “*mashtruarve*”, si dhe organizatorëve, shkon nga 200 (dyqind) deri në 250 (dyqind e pesëdhjetë) demonstrues, po ashtu pas tyre kemi edhe masa, sikur rasti i largimit të 105 (njëqind e pesë) anëtarve nga Lidhja Komuniste, si dhe largimi i mësuesve qoftë nga niveli fillor dhe ai i mesëm. Numri i të larguarve nga puna e mësimdhënësit, bazuar në gazetën Rilindja shkonte deri në 27 (njëzet e shtatë), mirëpo dënimet nuk do të liheshin me kaq. Demonstruesit e Drenasit ishin pjesë e demonstratave në Prishtinë, por edhe në demonstratën e Drenasit duke filluar nga muaji mars dhe muaji prill i vitit 1981. Nga demonstratat e Drenasit dalin edhe parullat të cilat ishin të njohura, por kemi edhe parulla të cilat nuk ishin të njohura më parë.

Të akuzuarit e demonstratave akuzoheshin edhe për lexim dhe shkëmbim të literaturës “*armiqësore*” sikur rasti: “*Manifesti Komunist*” i Karl Marksit, ndërsa në një aktgjykim kur po pytej se çka e shtyri të jetë pjesë e këtyre demonstratave ishte po ky Manifest. Madje ai shtonte edhe pjesë nga leximet e tij ku thuhej se “*çdo kufi caktuar me luftë, shkakton luftën e re*”.

SUMMARY

Fatlum NIKA

THE 1981 DEMONSTRATIONS: LEGAL REPERCUSSIONS FOR PARTICIPANTS FROM THE MUNICIPALITY OF DRENAS

This study examines the individuals convicted in relation to the 1981 demonstrations from the municipality of Drenas, drawing conclusions based on archival documents and relevant literature. The research highlights how charges were filed against the demonstrators, primarily by two courts: local and municipal (Misdemeanor Court) as well as the central SFRY court (District Court in Prishtina). The study details the weapons (such as hard weapons, knives, and sticks) that demonstrators were allegedly equipped with on both days of the demonstrations.

The findings show that the political punishments affected a wide range of individuals from Drenas, including young men and women from various professions, such as doctors, teachers, chemists, and merchants. The newspaper *Rilindja* reported on August 11, 1981, that the number of demonstrators discovered or identified ranged from 200 to 250, including organizers and those who were misled. Furthermore, the consequences extended beyond the demonstrations themselves, with 105 members of the Communist League dismissed, and 27 teachers removed from their posts. The punishment also involved accusations of reading and exchanging “hostile” literature, including Karl Marx's *Communist Manifesto*, which was cited by one of the defendants as the reason for their participation in the demonstrations. This individual specifically referenced the Manifesto's statement: “Every border determined by war, causes a new war”.